



STRATEGJIA NACIONALLE PËR SHËNDETIN MENDOR TË TË RINJVE

2024 - 2026



Këshilli Rinor Nacional
i Maqedonisë



Regional Cooperation Council



British Embassy
Skopje



Република Северна Македонија
Министерство за труд
и социјална политика

Përmbajtja

Nocionet e përgjithshme dhe terminologjia	03
1. HYRJE	04
1.1. Përmbledhje e fushave të politikave të përfshira nga strategjia dhe drejtimet kryesore të veprimit	04
1.2. Baza e detyrimit për përgatitjen dhe propozimin e strategjisë	05
1.3. Afati kohor dhe buxheti i strategjisë	05
2. QASJA METODOLOGJIKE NË PËRGATITJE	06
2.1. Mostra	06
2.2. Përshkrimi i procesit të përfshirjes së palëve të interesuara në përgatitjen e strategjisë	06
3. ANALIZA E SITUATËS	07
3.1. Analiza e të dhënave të fituara përmes të rinjve	07
3.2. Analiza e të dhënave të marra nga intervistat me palët e interesuara përkatëse	10
4. KUADRI STRATEGJIK	11
4.1. Vizioni për zhvillimin e fushave	11
4.2. Parimet udhëzuese	13
4.3. Fushat prioritare, qëllimet e përgjithshme dhe të veçanta	14
Rekomandimet kryesore	16
5. KORNIZA E MONITORIMIT, VLERËSIMIT DHE RAPORTIMIT	18
5.1. Mjeti për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e mbledhjes së të dhënave	18
6. MENAXHIMI ME RREZIQE	20

Nocionet e përgjithshme dhe terminologjia

Termet e mëposhtëm janë pjesë e objektivave të Strategjisë për të Rinjtë për Shëndetin Mendor:

- **Promovimi i shëndetit mendor:** Aktivitete dhe ndërhyrje që synojnë forcimin e faktorëve mbrojtës dhe promovimin e shëndetit pozitiv mendor dhe mirëqenies tek të rinjtë.
- **Parandalimi:** Strategjitë dhe masat e zbatuara për të zvogëluar incidencën, fillimin dhe ndikimin e problemeve të shëndetit mendor tek të rinjtë përmes adresimit të faktorëve të rrezikut dhe promovimin e qëndrueshmërisë.
- **Ndërhyrja e hershme:** identifikimi dhe ndërhyrja në kohë për të adresuar problemet e shëndetit mendor në një fazë të hershme, me qëllim parandalimin e përparimit të problemeve dhe përmirësimin e rezultateve.
- **Stigma:** Qëndrimet negative, bindjet dhe stereotipet që lidhen me problemet e shëndetit mendor, të cilat mund të çojnë në diskriminim dhe të pengojnë personin të kërkojnë ndihmë.
- **Qasshmëria:** Shkalla deri në të cilën shërbimet dhe burimet e shëndetit mendor janë në dispozicion të të rinjve, pa pengesa të tilla si kufizime gjeografike, financiare ose kulturore.
- **Kujdes i integruar:** një qasje e koordinuar dhe bashkëpunuese që përfshin sektorë, profesionistë dhe organizata të ndryshme që punojnë së bashku për të siguruar kujdes holistik dhe mbështetje për nevojat e shëndetit mendor të të rinjve.
- **Edukimi për shëndetin mendor:** Njohuritë dhe të kuptuarit e shëndetit mendor, duke përfshirë aftësinë për të njohur shenjat e problemeve të shëndetit mendor, për të kërkuar ndihmë dhe për të promovuar mirëqenien mendore.
- **Rezistenca:** Aftësia për t'u përshtatur dhe për t'u përballur me fatkeqësitë, stresin dhe sfidat, duke promovuar rezultate pozitive të shëndetit mendor dhe rimëkëmbjen.
- **Mbështetja e moshatarëve:** Mbështetje dhe ndihmë e ofruar nga individë që kanë përjetuar sfida të shëndetit mendor, duke ofruar empati, mirëkuptim dhe përvoja të përbashkëta për të promovuar mirëqenien.
- **Ndërhyrje të bazuara në prova:** qasje, programe dhe trajtime që janë vërtetuar se janë efektive përmes hulumtimeve rigoroze dhe provave shkencore.
- **Vazhdimësia e kujdesit:** një gamë gjithëpërfshirëse shërbimesh dhe mbështetje në dispozicion të të rinjve në faza të ndryshme të nevojave të shëndetit mendor, duke përfshirë parandalimin, ndërhyrjen e hershme, trajtimin dhe mbështetjen e vazhdueshme.
- **Bashkë-dizajnimi:** Përfshirja e të rinjve, familjeve dhe palëve të interesuara në zhvillimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikave, programeve dhe shërbimeve të shëndetit mendor për të siguruar perspektivat dhe nevojat e tyre.
- **Kujdesi i informuar për traumën:** Një qasje që njeh ndikimin e traumës mbi shëndetin mendor dhe siguron që shërbimet të ofrohen në një mënyrë të ndjeshme, të sigurt dhe inkurajuese.
- **Mirëqenia:** një gjendje e funksionimit optimal mendor, emocional dhe social, ku individët mund të përballen me streset e përditshme, të kenë një ndjenjë qëllimi dhe të përjetojnë emocione pozitive.

- **Qasja e orientuar drejt rimëkëmbjes:** Përqendrimi në mbështetjen e të rinjve për të arritur qëllimet e tyre personale, për të ndërtuar rezistencë dhe për të rimarrë kontrollin e jetës së tyre, edhe gjatë menaxhimit të sfidave aktuale të shëndetit mendor.

1. HYRJE

1.1. Përmbledhje e fushave të politikave të përfshira nga strategjia dhe drejtimet kryesore të veprimit

Në kuadër të bashkëpunimit midis RCC, Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe KRNМ-së, bëhen përpjekje të vazhdueshme për të rritur ndërgjegjësimin për përfitimet e forcimit të shëndetit mendor të të rinjve, me qëllim promovimin dhe mbështetjen e mirëqenies së të rinjve si përparësi kryesore e secilës shoqëri dhe respektimin e interesave më të mira të të rinjve.

Prevalenca e sfidave të shëndetit mendor tek të rinjtë në Maqedoninë e Veriut është e konsiderueshme. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, çrregullimet e shëndetit mendor janë të përhapura në çdo vend dhe në Maqedoninë e Veriut vlerësohet se një në katër persona do të përjetojnë një problem të shëndetit mendor në një moment në jetën e tyre. Të rinjtë janë veçanërisht të prekshëm nga problemet e shëndetit mendor për shkak të sfidave dhe presioneve me të cilat përballen në këtë kohë të jetës së tyre.[1]

Dimensioni pozitiv i shëndetit mendor theksohet në përkufizimin mbi shëndetin të dhënë nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) dhe thotë se "Shëndeti është një gjendje e mirëqenies së plotë fizike, mendore dhe sociale, jo vetëm mungesa e sëmundjes ose dobësisë/plogështisë." [2]

Pandemia COVID-19 gjithashtu theksoi pabarazitë dhe dobësitë ekzistuese në sistemin e shëndetit mendor në Maqedoninë e Veriut. Qasja në shërbimet e shëndetit mendor është bërë edhe më e kufizuar për shkak të pandemisë, me rritje të kërkesës për shërbime dhe ndërprerje në ofrimin e shërbimeve.

Në përgjigje të pandemisë, ka pasur përpjekje për të promovuar shëndetin mendor dhe shërbimet për mbështetjen e të rinjve në Maqedoninë e Veriut. Për shembull, shërbimet për këshillim online dhe aplikacionet për shëndet mendor janë zhvilluar për të rritur qasjen në shërbimet e shëndetit mendor gjatë pandemisë. Kishte edhe fushata publike që synonin promovimin e shëndetit mendor dhe reduktimin e stigmës rreth shëndetit mendor. Është një perceptim i përgjithshëm se pandemia COVID-19 ka pasur ndikim të rëndësishëm në shëndetin mendor të adoleshentëve në Maqedoninë e Veriut, duke theksuar nevojën për vëmendje të vazhdueshme dhe investime në shërbimet e shëndetit mendor për të rinjtë, veçanërisht në kohë krize.

[1] https://cdn.who.int/media/docs/default-source/mental-health/mental-health-atlas-2020-country-profiles/mkd.pdf?sfvrsn=d3d038cd_5&download=true

[2] http://www.who.int/features/factfiles/mental_health/en/.

Përmbledhje e fushave të përfshira nga Strategjia:

- **Parandalimi dhe intevenimi i hershëm:** Strategjia përqendrohet në masat proaktive për parandalimin e problemeve shëndetësore mendor të të rinjve dhe strategjitë për ndërhyrje të hershme për të identifikuar dhe adresuar problemet në një fazë të hershme.
- **Ndërgjegjësimi dhe edukimi:** Thekson nevojën për rritjen e ndërgjegjësimit për shëndetin mendor të të rinjve, të zvogëlohet stigma dhe të promovohet edukimi për shëndetin mendor te të rinjtë, prindërit, stafit arsimor dhe komuniteti më i gjerë.
- **Qasja në shërbimet e shëndetit mendor:** Strategjia synon të përmirësojë qasjen në shërbime cilësore për shëndet mendor, për të rinjtë duke përmirësuar kapacitetin dhe qasjen e shërbimeve për shëndet mendor dhe profesionistëve.
- **Integrimi dhe bashkëpunimi:** Thekson rëndësinë e bashkëpunimit midis aktorëve të ndryshëm, duke përfshirë agjencitë qeveritare, organizatat jofitimprurëse, institucionet arsimore dhe organizatat me bazë në komunitet, për të krijuar një qasje holistike dhe të koordinuar për shëndetin mendor të të rinjve.
- **Mbledhja dhe hulumtimi i të dhënave:** Strategjia thekson rëndësinë e mbledhjes dhe hulumtimit të të dhënave për të fituar një kuptim gjithëpërfshirës të nevojave të shëndetit mendor të të rinjve, për të informuar vendimet për politikën dhe të monitorohet efektiviteti i ndërhyrjeve.

1.2. Baza e detyrimit për përgatitjen dhe propozimin e strategjisë

Strategjia 2024-2026 pasqyron hapat se si mund të arrijmë vizionin dhe si do të kontribuojmë në promovimin e shëndetit mendor të të rinjve, ku mirëqenia e të rinjve do të jetë një nxitës aktiv i zhvillimit social. Strategjia 2024-2026 do të udhëhiqet nga Agjenda 2030 dhe parimet e përgjithshme të Qëllimeve për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Për këto arsye, RCC, në bashkëpunim me KRNМ,propozoi përgatitjen e një Strategjie Nacionale për Shëndetin Mendor të të Rinjve 2024-2026. Qëllimi kryesor i Strategjisë lind nga nevoja për të zhvilluar një sistem ndërsektorial për mbështetjen e të rinjve. Bashkëpunimi i ngushtë i tre ministrive kryesore, Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, është çelësi i përgatitjes së Strategjisë, siç është pjesëmarrja e sektorit civil dhe komunitetit akademik.

1.3. Afati kohor dhe buxheti i strategjisë

Strategjia Nacionale për Shëndetin Mendor të të Rinjve miratohet për një periudhë trevjeçare, përkatësisht nga viti 2024 deri në vitin 2026. Strategjia gjithashtu përmban një plan A që parashikon masa dhe aktivitete, ekzekutorë, përkatësisht institucione/ organizata përgjegjëse, dinamike dhe afat për zbatim. Në këtë drejtim, çdo institucion/organizatë përgjegjëse dhe autoritet kompetent, është e nevojshme të parashikojë dhe planifikojë aktivitetet dhe t'i inkuadrojë ato në planifikimin e buxhetit në baza vjetore përmes programeve vjetore.

2. QASJA METODOLOGJIKE NË PËRGATITJE

Për përgatitjen e Strategjisë, u përdor një metodologji e kombinuar që përfshinte rishikimin e dokumentacionit dhe hulumtimin primar cilësor dhe sasior, me një analizë të të dhënave primare dhe sekondare. Në veçanti, u përdorën teknikat e mëposhtme të kërkimit për mbledhjen e të dhënave:

- Rishikimi i literaturës
- Analiza dhe hartëzimi i legjislacionit kombëtar dhe praktikave aktuale në fushën e shëndetit mendor të të rinjve në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe praktikave të mira botërore;
- Konsultimet individuale të ekspertëve dhe intervistat individuale gjysmë të strukturuar me palët e interesuara përkatëse
- Fokus grupet me palët e interesuara përkatëse
- Hulumtim elektronik për të rinjtë;

Hulumtimi përdori analiza tematike dhe një qasje hibride për të koduar të dhënat cilësore. Gjetjet e shqyrtimit të dokumentacionit dhe të dhënat e marra nga hulumtimi parësor u kombinuan me qëllim nxjerrjen e konkluzioneve themelore dhe dhënien e rekomandimeve për zbatimin e Strategjisë.

Të dhënat u analizuan në nivel sasior dhe cilësor, duke përdorur metodat e mëposhtme të kërkimit: metoda eksploruese, përshkruese, krahasuese dhe shpjeguese. Të dhënat sasiorë të siguruar nga hulumtimi analizohen në nivel univariate, bivariate dhe multivariate, duke përdorur procedura të përshtatshme statistikore në softuerin kompjuterik për analizën e të dhënave.

2.1. Mostra

Për nevojat e hulumtimit në lidhje me Strategjinë, u hartua një mostër e shtresuar e kuotave. Për këtë qëllim, u përdorën të dhënat zyrtare për përlogaritjet e popullsisë, të publikuara në faqen e internetit të ESHS-ë. Madhësia e mostrës u llogarit sipas një formule (me gabimin marginal 3% dhe nivelin e besimit 95%).

Për konsultimet individuale të ekspertëve, u intervistuan dhjetë ekspertë, përkatësisht ekspertë dhe persona kompetentë nga ministrinë, stafi akademik, sektori civil.

2.2. Përshkrimi i procesit të përfshirjes së palëve të interesuara në përgatitjen e strategjisë

Forcimi i marrëdhënieve midis Qeverisë dhe sektorit civil është një parim kyç i qeverisjes së mirë dhe është një investim i domosdoshëm në procesin e krijimit të politikave cilësore. Përmes pjesëmarrjes së palëve të interesuara, Qeveria ka qasje në burime të reja të ideve, informacionit dhe burimeve që janë të rëndësishme në procesin e politikëbërjes dhe vendimmarrjes. Konsultimet kontribuojnë në ndërtimin e besimit të ndërsjellë, zhvillimin e cilësisë së demokracisë dhe forcimin e kapaciteteve të sektorit të OJQ-ve.

Përfshirja e palëve të interesuara kaloi përmes procesit të informimit, konsultimit dhe pjesëmarrjes. Në praktikë, këto tre forma të ndërveprimit shpesh kombinohen në përgatitjen e rregulloreve, dhe kështu ishte edhe në kuadër të kësaj strategjie ku u përfshinë të gjithë aktorët përkatës.

3. ANALIZA E SITUATËS

Në pjesën që vijon, do të paraqesim rezultatet e fituara nga hulumtimi jonë të kryer, dhe kështu do të kemi një ide të qartë të konceptit të shëndetit mendor të të rinjve, përkatësisht sa të njohur janë të rinjtë me këtë koncept dhe sa direkt ose indirekt e zbatojnë atë, natyrisht, brenda familjeve në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nga regjistrimi i fundit i popullsisë dhe familjeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2021 [3], dihet se në vend jetojnë gjithsej 1,836,713 qytetarë. Nga popullsia e përgjithshme, 21.5% janë fëmijë dhe adoleshentë të moshës 0-18 vjeç. Shpërndarja sipas grup-moshës përfshin: 24.5% fëmijë parashkollorë (0-4 vjeç), 27.7% fëmijë të moshës shkollorë (5-9 vjeç) dhe 47.8% fëmijë adoleshentë (10-18 vjeç). Numri i familjeve është 598.632, ndërsa numri mesatar i anëtarëve të familjes është 3.06.

3.1. Analiza e të dhënave të fituara përmes të rinjve

Për nevojat e hulumtimit në lidhje me Strategjinë, u hartua një mostër e shtresuar e kuotave. Për këtë qëllim, u përdorën të dhënat zyrtare për përllogaritjet e popullsisë, të publikuara në faqen e internetit të ESHS-ë. Madhësia e mostrës u llogarit sipas një formule (me gabimin marginal 3% dhe nivelin e besimit 95%).

Mostra e të rinjve përfshinte 1851 të rinj të moshës 15 deri në 29 vjeç, nga të cilët 56.3% ishin femra dhe 42.7% meshkuj, me një moshë mesatare 23.12 vjeç ($M=23.12$, $SD=1.17$). Sipas një numri të madh të hulumtimeve, personat me nivel më të lartë arsimimi dhe gratë janë më të gatshme të marrin pjesë në hulumtime në internet, prandaj dallimi i madh në përqindjen midis pjesëmarrësve meshkuj dhe femra në hulumtim [4]. Nga numri i përgjithshëm i të rinjve, 14% deklaruan se ballafaqohen me një problem shëndetësor ose paaftësi, siç janë çrregullimet në zhvillim, problemet e shëndetit mendor, ankthi dhe depresioni, ndërsa 18% e fëmijëve deklaruan se kishin alergji. Më shumë se 85% e tyre deklaruan se vijnë nga familje me dy prindër, 5% nga familje të divorcuara dhe më pak se 2% nga prindër që jetojnë në bashkësi jashtëmartesore ose janë prindër të vetëm. Për më tepër, 72% e të rinjve deklaruan se jetojnë në një mjedis urban dhe 72% theksuan se prindërit e tyre janë të punësuar. Megjithatë, një numër i konsiderueshëm i të rinjve (14.5%) jetojnë në familje ku të dy prindërit janë të papunë.

[3] Enti Shtetëror i Statistikës. (2021). Regjistrimi i popullsisë, familjeve dhe banesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut - grupi i parë i të dhënave.

[4] Smith, G. (2008). Does gender influence online survey participation?: A record-linkage analysis of university faculty online survey response behavior. ERIC document reproduction service no. ED 501717.

Popullsia e re e mbuluar nga Studimi është e moshës 15 deri në 29 vjeç, dhe aktualisht përbëhet nga një grup gjeneratash, i njohur në të gjithë botën si Gjenerata M. Këta të rinj, përveç që ishin dëshmitarë të ndryshimeve dhe zhvillimeve dinamike në nivel global (zhvillimi i shpejtë i teknologjisë dhe përdorimi i gjerë i internetit, ndryshimet klimatike dhe fatkeqësitë natyrore, sulmet dhe luftërat terroriste, kriza ekonomike), ishin drejtpërdrejt ose tërthorazi pjesë e zhvillimeve të trazuara politike dhe sociale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, veçanërisht në periudhën e kaluar, siç janë: kriza politike, zhvillimet në lidhje me dukuritë negative shoqërore në dekadat e fundit, protestat studentore, Revolucioni Iarman [5]. Përveç ndikimit në proceset demokratike në vend, ngjarje të tilla padyshim kanë ndikuar në shkallë të ndryshme në qëndrime të caktuara të të rinjve.

Ajo që na tregojnë të dhënat është se nëna është figura dominuese tek e cila 50% e të rinjve shumë shpesh i drejtohen për mbështetje, ndryshe nga babai që është i dyti, dhe më pas vijnë miqtë. Institucionet shtetërore shumë rrallë perceptohen si një vend ku të rinjtë drejtohen për ndihmë.

Deri në 64% e të rinjve, në muajin e kaluar, kishin mosmarrëveshje me prindërit e tyre, kryesisht për shkak të shkollës (34%), mediave sociale (17%), financave (15%), marrëdhënieve familjare (12%). 40% e fëmijëve theksojnë se forma më e zakonshme e konfrontimit me prindërit është biseda, por ende përdoren metoda disiplinore si heqja e objekteve, injorimi, nënçmimi dhe madje edhe shuplakat, gjë që korrespondon me përgjigjet e prindërve. Ajo që është alarmante është se vetëm 4.8% e të rinjve kaluan aq kohë cilësore me prindërit e tyre sa donin, ndërsa 30% e të rinjve nuk kanë kaluar asnjë kohë cilësore me prindërit e tyre gjatë muajit të kaluar.

Të dhënat e marra nga pyetësi na japin një pasqyrë të plotë të grupit të synuar, faktorëve të rrezikut, si dhe problemeve më të zakonshme me të cilat përballen këta të rinj. Frika më e madhe me të cilën përballen 40% e të rinjve është vetmia, frika nga refuzimi (33%), izolimi nga miqtë (27%). Për më tepër, një nga problemet më të zakonshme me të cilat përballen këta të rinj lidhet me shëndetin dhe mungesën e kujdesit adekuat shëndetësor (26%).

Nga ana tjetër, përgjigjet e drejtpërdrejta të të rinjve japin një pasqyrë edhe më të qartë të perceptimit të tyre dhe mënyrës se si ata e përjetojnë jetën e përditshme. Një tregues paralajmërues është se 15% e të rinjve donin të largoheshin nga vendi ku jetojnë tani për disa arsye siç janë mungesa e mbështetjes nga prindërit, ekspozimi ndaj dhunës emocionale, detyrimi i punës së detyruar dhe më shumë.

Përveç kësaj, ajo që na interesonte në këtë analizë ishte cilësia e jetës dhe vetë-kujdesi. Ajo që është e rëndësishme është që një pjesë e madhe e të rinjve të ndjehen të dashur dhe të shëndetshëm (68%). Por ende, brenda mesatares, ka të rinj që ndihen të trishtuar, të stresuar dhe të padisponueshëm.

[5] <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/skopje/15292.pdf>

Ajo që është alarmante është se kur ndihen të trishtuar ose të mërzhitur, vetëm gjysma e të rinjve flasin me dikë për ndjenjat e tyre dhe 36% nuk kanë me kë të flasin.

Ajo që është ende një tregues pozitiv është se të rinjtë në përgjithësi ndihen të sigurt, më të sigurt në shtëpi, dhe më pak të sigurt në internet.

Ajo që lind nga pyetjet shtesë të hapura që të rinjtë iu përgjigjën si sfidë është si më poshtë: shumë për të mësuar dhe pa kohë të lirë për të luajtur; transporti i pamjaftueshëm në shkollë; nevoja për udhëzime shtesë për lëndë të caktuara brenda shkollës, për të kursyer buxhetin vendas në kohë krize; mbështetje më e madhe për kategoritë më të rrezikuara të të rinjve, etj.

Për më tepër, të dhënat në këtë Analizë na tregojnë se:

- 89% e të rinjve kanë qasje në internet.
- Gjithsej 62% e të rinjve janë të ekspozuar ndaj disa rreziqeve në internet.
- 37% e të rinjve përjetuan dhunë digjitale
- Gjithsej 22% e të rinjve kanë parë ose dëgjuar se bashkëmoshatarët e tyre vuajnë nga dhuna digjitale.

Ajo që na interesonte gjithashtu ishte se çfarë bëjnë të rinjtë kur ekspozohen ndaj dhunës digjitale?

- Bisedojnë me një mik (15%).
- Bisedojnë me prindërit (22%)
- Bisedojnë me person të rritur nga shkolla (mësimdhënës, psikolog, pedagog, etj.) (11%)
- Përpiqen të flasin me personin që ka kryer dhunë (2%)
- Nuk bëjnë asgjë (4%)
- Përpiqen t'ia kthejnë me të njëjtën masë (3%)
- Diçka tjetër (6%).

Gjatë shqyrtimit të përvojave të të rinjve, ishte jashtëzakonisht e rëndësishme për ne të kapnim ndikimin indirekt, atë që ndodh përmes dëshmisë së përvojave të të afërmeve. Mjedisi në të cilin rriten të rinjtë është burim i ndjenjës së sigurisë, ngrohtësisë, mbështetjes. Prandaj, nuk është për t'u habitur që çdo ngjarje që ndikon në nivele të ndryshme të mjedisit të të rinjve, siç është familja ose shkolla, mund të ndikojë indirekt në mirëqenien psikologjike të fëmijës, si dhe të dëmtojë ose forcojë elasticitetin e tij. Të dhënat e marra në këtë mënyrë tregojnë se shumica e të rinjve preken nga pandemia në një farë mënyre, qoftë përmes përvojave të tyre ose përvojave të të dashurve. Të dhënat e marra treguan se 1 në 10 të rinj (9%) kishin ankth të madh dhe / ose simptoma depresive, të cilat tejkalojnë nivelin e përvojave të pakëndshme emocionale që do të konsideroheshin të pritshme për moshën. Çdo i ri i shtatë (15%) përjeton një nivel të konsiderueshëm të simptomave të stresit post-traumatik, domethënë, ndryshime në emocionalitetin dhe sjelljen që ndodhin si rezultat i një përvoje që mund të përshkruhet si traumatike. Sa i përket pranisë së këtyre ndryshimeve, nuk u gjet asnjë ndryshim i rëndësishëm midis fëmijëve në shkollat fillore dhe të mesme, por rezultoi se vajzat janë në rrezik më të lartë, domethënë më shpesh sesa djemtë tregojnë nivele të larta ankthi dhe / ose depresioni dhe stresi post-traumatik.

Nëse shikojmë përvojat e të rinjve në nivelin e përvojave individuale, mund të shohim se numrat po rriten ndjeshëm, domethënë që shumica e të rinjve i ndejnë ndryshimet në funksionimin psikologjik në një masë më të madhe ose më të vogël. Në suazat e përvojave që i përkasin rrethit të reaksioneve të stresit post-traumatik, shohim se gjysma e fëmijëve e kanë përjetuar atë të paktën në një moment.

- vështirësi në përqendrim (56%)
- shqetësim në kujtesën e një ngjarjeje stresuese (51%)
- ndjeshmëria emocionale/ ndrojtja (51)
- përmbajtje imponuese (49%)
- shmangie e kujtimeve dhe ndjenjave të pakëndshme (44%)

Për më tepër, duke parë ankthin dhe depresionin, shohim se shqetësimet e të rinjve janë rritur gjatë kësaj periudhe. Deri në tre nga katër të rinj në vitin e kaluar përjetuan një frikë të dështimit (74%) dhe 60% ankth në situata sociale. Në pothuajse gjysmën e të rinjve gjithashtu u vërejtën:

- ndjenja trishtimi dhe boshllëku (48%)
- brengosje për sigurinë e anëtarëve të familjes (47%)
- frika për të mbetur vetëm në shtëpi (39%)

3.2. Analiza e të dhënave të marra nga intervistat me palët e interesuara përkatëse

Qeveria e Maqedonisë njohu rëndësinë e shëndetit mendor dhe ndërmori hapa për të përmirësuar shërbimet e shëndetit mendor në vend. Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria për Punë dhe Politikë Sociale janë dy organet kryesore qeveritare përgjegjëse për shëndetin mendor në Maqedoni.

Ministria e Shëndetësisë është përgjegjëse për ofrimin e kujdesit dhe shërbimeve të shëndetit mendor për popullatën. Ministria ka ngritur disa qendra të shëndetit mendor në të gjithë vendin dhe ka rritur fondet për shërbimet e shëndetit mendor në vitet e fundit. Ministria gjithashtu ka hartuar një strategji kombëtare të shëndetit mendor 2018-2025, e cila synon të përmirësojë qasjen në kujdesin e shëndetit mendor dhe të zvogëlojë stigmën rreth sëmundjes mendore.

Ministria për Punë dhe Politikë Sociale është përgjegjëse për zhvillimin e politikave në lidhje me mbrojtjen sociale, përfshirë shëndetin mendor. Ministria u përfshi në iniciativa që synojnë përmirësimin e kujdesit për shëndetin mendor për popullatat në rrezik, përfshirë fëmijët dhe të rinjtë. Përveç kësaj, Ministria bëri thirrje për rritje të fondeve për shërbimet e shëndetit mendor dhe punoi për të rritur ndërgjegjësimin për problemet e shëndetit mendor në vend.

Në përgjithësi, Qeveria e Maqedonisë njohu rëndësinë e shëndetit mendor dhe ndërmori hapa për të përmirësuar shërbimet e shëndetit mendor në vend. Ndërsa ka ende shumë punë për të bërë për të përmirësuar qasjen në kujdesin e shëndetit mendor dhe për të zvogëluar stigmën, përpjekjet e qeverisë përfaqësojnë një hap të rëndësishëm përpara në adresimin e problemeve të shëndetit mendor në vend.

Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria për Punë dhe Politikë Sociale në Maqedoni bënë disa rekomandime në lidhje me shëndetin mendor. Ja disa shembuj:

- **Përmirësimi i qasjes në shërbimet e shëndetit mendor:** Ministritë rekomanduan përmirësimin e qasjes në shërbimet e shëndetit mendor duke rritur numrin e profesionistëve të shëndetit mendor dhe qendrave të shëndetit mendor në vend.
- **Reduktimi i stigmës rreth sëmundjes mendore:** Ministritë rekomanduan fillimin e fushatave për të zvogëluar stigmën dhe diskriminimin në lidhje me sëmundjen mendore. Kjo mund të përfshijë fushatat e ndërgjegjësimit publik, programet arsimore dhe fushatat mediatike.
- **Forcimi i politikave dhe legjislacionit për shëndetin mendor:** Ministritë rekomanduan forcimin e politikave dhe legjislacionit për shëndetin mendor në vend. Kjo mund të përfshijë zhvillimin e një strategjie kombëtare të shëndetit mendor, zbatimin e politikave të shëndetit mendor dhe përmirësimin e kuadrit ligjor në lidhje me shëndetin mendor.
- **Forcimi i mbështetjes për popullatat e rrezikuara:** Ministritë rekomanduan ofrimin e mbështetjes së zgjeruar për popullatat e rrezikuara, të tilla si fëmijët dhe të rinjtë, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara. Kjo mund të përfshijë shërbime dhe programe të specializuara të shëndetit mendor që adresojnë nevojat unike të këtyre popullatave.
- **Rritja e fondeve për shërbimet e shëndetit mendor:** Ministritë rekomanduan rritjen e fondeve për shërbimet e shëndetit mendor në vend. Kjo mund të përfshijë shpërndarjen e më shumë burimeve për qendrat e shëndetit mendor dhe profesionistët e shëndetit mendor, si dhe rritjen e mjeteve për kërkime dhe fushatave për ndërgjegjësimin publik.

4. KUADRI STRATEGJIK

4.1. Vizioni për zhvillimin e fushave

Vizioni i Strategjisë Nacioanle është promovimi dhe afirmimi i mirëqenies mendore, parandalimi dhe minimizimi i sëmundjeve mendore dhe sigurimi i qasjes në kujdes shëndetësor mendor me cilësi të lartë për të gjithë.

Qëllimet më të rëndësishme janë:

- Rritja e ndërgjegjësimit për çështjet e shëndetit mendor tek të rinjtë dhe zvogëlimi i stigmës rreth shëndetit mendor.
- Të përmirësohet qasja në shërbimet e shëndetit mendor për të rinjtë, duke përfshirë zhvillimin e shërbimeve të bazuara në komunitet.
- Të promovohet ndërhyrja e hershme dhe parandalimi i problemeve të shëndetit mendor, nëpërmjet zbatimit të ndërhyrjeve dhe programeve të bazuara në prova.
- Të sigurohen që shërbimet e shëndetit mendor të jenë me cilësi të lartë dhe të ndjeshme nga pikëpamja kulturore dhe të arritshme për të gjithë të rinjtë, pavarësisht nga statusi i tyre socio-ekonomik ose vendndodhja gjeografike.

- Të nxitet bashkëpunimi midis sektorëve të ndryshëm, përfshirë shëndetësinë, arsimin dhe shërbimet sociale, për t'iu përgjigjur përcaktuesve kompleksë socialë të shëndetit mendor të të rinjve.

Në përgjithësi, misioni dhe vizioni i Strategjisë Nacionale për Shëndetin Mendor të të Rinjve në Maqedoninë e Veriut synon të adresojë sfidat dhe çështjet aktuale që kanë të bëjnë me shëndetin mendor të të rinjve dhe të promovojë një qasje gjithëpërfshirëse, të integruar dhe të bazuar në prova për promovimin, parandalimin dhe avancimin e shëndetit dhe mirëqenies mendore të të rinjve.

Janë identifikuar tre qëllime kryesore për arritjen e vizionit:

Qëllimi 1: Promovimi i rëndësisë së shëndetit mendor dhe mirëqenies tek të rinjtë.

